

VENDIM
Nr. 72, datë 3.2.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
NDËRTIMIT TË OBJEKTIT “POLI I RI ADMINISTRATIV”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE BUBQ, BASHKIA KRUIJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË
KRUIJË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit “Poli i ri administrativ”, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, në vlerën 238 129 843 (dyqind e tridhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, për financimin e ndërtimit të objektit “Poli i ri administrativ”, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 47 625 968 (dyzet e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese për ndërtimin e objektit “Poli i ri administrativ”, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të objektit “Poli i ri administrativ” i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, njësisë zbatuese, Bashkisë Krujë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe